

**STATUT  
I SHOQERISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"KOALS Sh.p.k."**

Në bazë të Ligjit n. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), me vullnetin e tij të lirë e të plotë të shprehur me nënshkrimin e këtij Statuti, Ortaku i vetem i Shoqërisë në themelim:

- Z. Arian Zeneli, i biri i Brahimit, lindur me date 23.08.1986 ne Patos, Fier dhe banues ne Tirane ne adresen Rr.Teodor Keko, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. 025114448 dhe nr. personal I60826067V;**

hartonë këtë Statut me përbajtjen që vijon:

**Neni 1  
Emri i Shoqërisë**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është emërtuar "**KOALS Shpk**".

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB") me emrin "**KOALS Shpk**" (në vijim "Shoqëria").

**Neni 2  
Selia e Shoqërisë**

Shoqëria KOALS Shpk e ka selinë ligjore në Rruga "Albion Tershalla", zona Unaza e Re, Kompleksi i pallateve "Santara", kati i pare, njesia nr. 23, zona kadastrale nr. 3866, pasuria nr.214/344-N23,Yzberisht, Tirane.

Asambleja e Ortakëve mund të vendosë për transferimin e selisë së Shoqërisë, ose themelimin apo mbylljen e degëve dhe/ose zyrate të përfaqësimit apo zyra administrative brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe / ose jashtë saj.

**Neni 3  
Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Kohëzgjatja e Shoqërisë fillon nga momenti i regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me është me afat të pakufizuar.

Shoqëria fiton personalitet juridik nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 4**

Shoqeria ka per objekt brenda dhe jashte territorit te Republike se Shqiperise, dhe pa u kufizuar ne:

- Ne fushen e ndertimit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, supermarrjen zbatuese dhe /ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si : ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhere, dhe te gjitha veprave te tjera madhere, ujesjellesave, linjave mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe reabilitimin e veprave ujitese, centralet, objektet

turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, te gjitha restaurimet ne per gjithesi, te gjitha rikonstruksioneve te ndertesave civile dhe industriale, rikonstruksione te veprave te artit, mirembajtje, montimet e konstruksioneve metalike; si dhe çdo ndertim tjeter i cili ne perfundim perben send te paluajtshem sipas nenit 142 te Kodit Civil per shkak te trupezimit ne menyre te qendrueshme e te vazhdueshme me token ose ndertesen ku eshte vendosur.

- Ne fushen e sherbimeve shoqeria do te kryeje: Konsulencë teknike ne fusha te ndryshme, supervizion, menaxhimet dhe studimet e te gjitha llojeve, realizimi i kontratave, marreveshjeve, ortakerive, shoqerive te perbashketa apo forma te tjera, veprimitari komisionere, perfaqsim, si dhe veprime te tjera te porositura nga te tretet te lejuara nga legjislacioni shqiptar;  
konsulencë, revizion, ekspertize, vleresime te kapitaleve dhe gjendjes, planbizneseve, projekte zhvillimi dhe studime te efektivitetave ekonomike, percaktimi i prioriteteve ne fusha te ndryshme te ekonomise etj.  
Administrim fondesh dhe/ose investimesh; Sherbime ne fushen e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, duke perfshire pa u kufizuar ne sherbime agjencie real estate, qiradhenie- qiramarrje e hapesirave reklamuese, qiradhenie, sherbime informacione biznesi, sherbime administrimi, menaxhimi, mirembajtje, riparim, ndermjetesim etj.

- Ne fushen e tregtise shoqeria do te kryeje: Tregtimin dhe import-eksportin me shumice e pakice, te te gjithe mallrave me ose pa akcize, duke perfshire por pa u kufizuar ne, industriale, ushqimore, mjekesore, bujqesore, blegtorale, elektroshtepiak, te ndertimit (hidro-sanitare, elektrike, mobileri), te mediave, te mjeteve kryesore dhe ndihmese te prodhimit, te makinerive, te te gjitha mineraleve, te lendet drusore, te lendeve te para dhe te perpunuara per procesin e prodhimit; tregtimin e pasurive te luajtshme e te paluajtshme shitblerjen e tokes, tregtimin e mallrave te gatshem e gjysem te gatshme; transaksione ne burse, shitblerje lettrash me vlere etj; tregtimin me pakice te naftes, gazit natyror dhe nenprodukteve te tyre;

Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, me qellim arritjen e objektivave te mesiperme, shoqeria mund:

- a) te perdore (per vete) te gjitha sherbimet dhe prodhimet brenda objektit te veprimitarise se saj, te ofruara dhe/ose prodhua nga ajo vete apo te Tretet.
- b) te kryeje cdo transaksion ne lidhje me pasurite e luajtshme apo ato te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, te vendose pengje dhe barre hipotekare; aktivitetet keto te konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper;  
Shoqeria do te kryeje cdo lloj aktiviteti ne raport me objektin dhe per te favorizuar ate. Shoqeria zbaton te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore te duhura. Ajo zbaton standartet me te larta te etikes.

## Neni 5

### Kapitali i Shoqërisë

- 5.1. Kapitali fillestar i Shoqërisë është ALL 10,000 (dhjetemije) dhe konsiston në 1 (nje) kuot, e cila zotërohet nga ortaku i vetem i shoqerisene masen 100% të kapitalit të shoqërisë.

- 5.2 Kapitali fillestar i Shoqërisë mund të zmadhohet apo zvogëlohet dhe është tërësisht i likuidueshëm dhe i nënshkrueshëm.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet në çdo kohë me një vendim të Asamblesë së Ortakëve e miratuar me shumicën e cilësuar të parashikuar nga Statuti. Në rast të një zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit në proporcion me kuotën që zoterojnë, me mënyrën e parashikuar nga Asambleja e Përgjithshme.

Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin pas një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të miratuar me shumicën e cilësuar ne Statut. Në çdo rast, kapitali nuk do të reduktohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

Zvogëlimi i kapitalit mbështetet nga çdo ortak në proporcion me pjesën e mbajtur në Shoqëri.

- 5.3. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestar i saj, nga pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe nga pasuri të tjera të konsideruara ose që do të konsiderohen si të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së Shoqërisë.
- 5.4. Kuotat e kapitalit derdhen në bankë nga ortakët, në llogarinë rrjedhëse në emër të Shoqërisë.
- 5.5. Kapitali fillestar është nënshkruar tërësisht nga ortaket e Shoqërisë.
- 5.6. Ortaket e Shoqërisë kane të drejtën të térheqin fondet e depozituara si kapital fillestar të Shoqërisë, në rastin në të cilin Shoqëria nuk regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e depozitimit të fondit.

## **Neni 6** **Transferimi i Kuotave**

- 6.1. Transferimi i kuotave është i vlefshëm ndaj ortakëve të Shoqërisë si me akt midis të gjallëve ashtu dhe me trashëgimi, vetëm në rast se rezulton se janë respektuar dispozitat e këtij nenit.
- 6.2. Në rast transferimi të kuotave midis të gjallëve me akt, ortakëve i takon e drejta e parablerjes të kuotave të shoqërisë. Ortaku shitës si fillim duhet t'i bëjë një ofertë ortakeve të tjerë me letër rekomande, në të cilën të përcaktojë çmimin e kërkuar për shitjen e kuotës së tij. Në këtë rast secili nga ortakët, në proporcion me pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë, gëzon të drejtën e parablerjes.
- 6.3. Në rast mosmarrëveshjesh mbi çmimin e kërkuar, me kërkesë të palëve të interesuara, çmimi do të përcaktohet nga një ekspert kontabël i miratuar me shumicë të thjeshtë nga Asambleja e Ortakëve, i cili do të përcaktojë çmimin e shitjes në bazë të vlerës reale të kuotave.
- 6.4. Në rast mosmarrëveshjeje mbi emërimin e ekspertit kontabël, i cili do të emërohet me shpenzime të secilës palë, me kërkesë të palës së interesuar do të zgjidhet nga gjykata e vendit ku ka selinë shoqëria. Eksperti duhet të kryejë vlerësimet sipas kritereve dhe mënyrave të parashikuara nga legjislationi shqiptar.

Pas vlerësimit të kuotave nga ana e ekspertit, si shitësi por ashtu edhe blerësi, kanë të drejtë të tërhiqen përkatësisht nga shitja dhe blerja. Në këtë rast shpenzimet e ekspertit do të jenë në ngarkim të palës që tërhiqet.

- 6.5. Ortaku shitës i kuotave duhet t'i transferojë këto të fundit me akt të shkruar ortakëve blerës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njohimit dhe në rast të vlerësimit të bërë nga eksperti kontabël, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e vlerësimit.
- 6.6. E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet brenda një periudhe 30 (tridhjetë) ditore duke filluar nga data e njohimit të ofertës ose brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e përcaktimit të çmimit nga ana e ekspertit kontabël të emëruar. Pasi kanë kaluar afatet e mësipërme, shitësi ka të drejtën të transferoje tek palë të treta kuotën e tij.

### **Neni 7 Fitimet e Shoqërisë**

- 7.1. Fitimet e Shoqërisë i takojnë ortakëve të saj.
- 7.2. Asambleja vendos sipas ligjit për ndarjen ose ri qarkullimin e tyre, duke përcaktuar edhe mënyrat.

### **Neni 8**

Shoqëria do të përdorë dhe disponojë pasurinë e saj të akumuluar. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, materiale ose jo materiale, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurisë së akumuluar tek të tretët. Në Republikën e Shqipërisë, Shoqëria gjëzon të drejta sikundër çdo person tjetër juridik shqiptar ose i huaj, sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 9**

Shoqëria vepron në regjin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët mbartin rrezikun e veprimitarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në të.

### **Neni 10 Drejtimi dhe administrimi i Shoqërisë**

Bëjnë pjesë në detyrat dhe kompetencat e ortakëve të mbledhur në Asamblenë e Përgjithshme të gjitha ato që janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe të listuar në ketë Statut. Ndër këto detyra përfshihen:

1. ndryshimi i aktit të themelimit dhe statutit;
2. miratimi i buxhetit vjetor, të raporteve të administrimit, të inventarit, të bilancit dhe llogarive vjetore;
3. emërimi e shkarkimi i administratorëve, qofshin ortakë ose jo, dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të tyre, duke përcaktuar se qoftë për emërimin ashtu edhe për shkarkimin nuk do të jetë e domosdoshme të jepet shprehimisht motivi;
4. miratimi i kredive dhe garancive;
5. miratimi i tarifave për shërbimet që kryen Shoqëria;

6. përcaktimi i formës së vulës dhe të markës së Shoqërisë;
7. zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë;
8. mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
9. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve te ecurisë se veprimtarisë se Shoqërisë;
10. vendimi lidhur me krijimin apo mbylljen e degëve, zyrate të përfaqësimit ose agjencive të Shoqërisë;
11. vendimi për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
12. vendimi për fillimin apo për zgjidhjen e një mosmarrëveshje ligjore në të cilën është e përfshirë Shoqëria, duke autorizuar administratorin e Shoqërisë për të vepruar;
13. vendimi për emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar apo të konsulentëve të tjera, qofte persona fizikë apo juridikë;
14. vendimi për ndarjen e kotave dhe për anulimin tyre;
15. vendimi për miratimin dhe ndryshimin e procedurës për mbledhjen e asamblesë;
16. vendimi për dhënien ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të Shoqërisë;
17. vendimi për shitjen e kuotave të Shoqërisë;
18. vendime për çështje të tjera të parashikuara me ligj apo nga statuti;
19. marrjen e çdo vendimi tjeter që nuk i është deleguar ndonjë organi tjeter.

### **Neni 11** **Asambleja e Përgjithshme**

- 11.1. Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit.
- 11.2. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga administratori drejt Ortakëve me shkresë ose, sipas zgjedhjes së administratorit, nëpërmjet postës elektronike. Adresat elektronike (e-mail) të ortakëve regjistrohen në bazën e të dhënave të Shoqërisë.
- 11.3. Njoftimi për mbledhjen e asamblesë duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 11.4. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas mënyrës së lartpërmendor, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët janë dakord për të marrë këto vendime, pavarësisht nga mungesa e njoftimit.
- 11.5. Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim. Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbale. Prosesverbalit duhet të mbajë datën, vendin, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të mbledhjes dhe Sekretarit që mban procesverbalin, i cili mund të jetë edhe jo ortak apo jo punëmarrës i Shoqërisë, si dhe rezultatin e votimit dhe duhet të nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari. Prosesverbalit i bashkëlidhet lista e të pranishmëve dhe thirrja.

- 11.6. Pjesëmarrja apo votimi në Asamblenë e Përgjithshme mund të kryhet edhe nëpërmjet mjeteve elektronike në mënyrën e parashikuar në ligj. Procesverbali i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të Shoqërisë nën kujdesin e administratorit.
- 11.7. Asambleja e përgjithshme mund të mblidhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në ketë rast vendimet e asamblesë së përgjithshme të marra jashtë territorit te Republikës së Shqipërisë, do t'i nënshtrohen procedurave të parashikuara nga ligji shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Shqipëri dhe duhet të jenë në përputhje me parashikimet e këtij statuti për sa i takon kuorumi dhe shumicës në marrjen e vendimeve.
- 11.8 Asambleja e Përgjithshme, përvèç rasteve parashikimeve të nenit 11.10 të këtij Statuti, vodos me votën pro të shumicës së ortakëve, nëse ortakët që marrin pjesë në mbledhje me të drejtë vote përfaqësojnë më shumë se 30% (tridhjete për qind) të kapitalit të shoqërisë.
- 11.10 Asambleja e Përgjithshme vodos me 75% (shtatëdhjetepesë për qind) të votave të ortakëve, nëse ortakët që marrin pjesë me të drejtë vote përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë. Çështjet për të cilat kërkohet shumica e cilësuar janë:
  - a) Ndryshimet e Statutit;
  - b) Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit;
  - c) Shpërndarja e fitimeve;
  - d) Riorganizimi, prishja dhe likuidimi i Shoqërisë dhe degëve të saj.

## **Neni 12** **Administrimi i Shoqërisë**

- 12.1. Administrator i Shoqërisë është Z. **Arian Zeneli**.
- 12.2. Administratori i Shoqërisë emërohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe ushtron të gjitha veprimtaritë e administrimit te zakonshëm të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, me përashtim të kompetencave që vetë ligji apo statuti ja delegon shprehimisht ortakëve.  
Për çështje me rendësi të veçantë, administratori konsultohet me ortakët dhe adopton masat e vendosura nga asambleja e ortakëve me shumicat e parashikuara me ligj.
- 12.3. Administratori emërohet për një afat 3 (tre) vjeçar duke filluar nga data e emërimit, me të drejtë riemërimi.
- 12.4. Asambleja e Përgjithshme emëron dhe revokon administratorin apo administratorët në detyrë dhe mund të emërojë administratorë të tjera me kompetencia të përcaktuara sipas parashikimeve ligjore dhe nga akti i autorizimit.
- 12.5. Administratori ka të drejtë të japë dorëheqjen e parakohshme, përpëra mbarimit te mandatit, me njoftim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme. Administratori që jep dorëheqjen është i detyruar të kërkojë mbledhjen e

Asamblesë për emërimin e administratorit të ri para se dorëheqja të hyjë në fuqi.

- 12.6. Asambleja e Përgjithshme mund të emërojë më shumë se një administrator, të çfarëdo kombësie edhe te jashtëm për Shoqërinë. Në rastin e emërimit te një apo me shume administratoreve ne fuqi, secili nga administratorët mund të ushtrojë të gjitha tagrat e përfaqësimit dhe të firmës ashtu si rezultojnë në aktin e emërimit të tyre. Secili nga ata do të jetë individualisht përgjegjës për përbushjen e funksioneve te dhëna nga ligji për administratorin dhe do ti komunikojë të tjerëve ose administratorit tjetër veprimet nga ai të kryera.

### Neni 13

- 13.1. Administratoret kryejnë detyrat e përcaktuara nga Asambleja e Ortakëve e, Shoqërisë në këtë Statut dhe të gjitha ato detyra të parashikuara dhe të rregulluara me ligj. Ndërsa këto përshtinen detyrat e renditura më poshtë.
1. Të veprojë dhe të nënshkruajë në emër të Shoqërisë.
  2. Të hartoje rregulloren e brendshme të Shoqërisë dhe një plan biznesi për vitin finanziar, që do të miratohet në Asamblenë e Përgjithshme.
  3. Të marrë vendime lidhur me kreditë që do të merren dhe dhënien e garancive.
  4. Të përpunojë dhe të paraqesë për miratim në asamblenë e përgjithshme raporte për sezonin e aktivitetit të shoqërisë dhe të bilancit të mbylljes së aktivitetit financiar të vitit paraardhës, sipas asaj që parashikohet në ligj.
  5. Të mbajë në rregull regjistrin e vendimeve të asamblesë së përgjithshme.
  6. Të kryejë të gjitha veprimitaritë e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme.
  7. Të përfaqësojë Shoqërinë.
  8. Të kujdeset përmes mbajtjen e dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë me korrektësi dhe saktësi.
  9. Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
  10. Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
  11. Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e vprimeve të posaçme me rendësi të veçantë përmes veprimitarit të Shoqërisë.
  12. Të emërojë financierë e konsulentë për problemet e shoqërisë. Financieri nxjerr rregullisht indikatorët financiarë të tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, përmes aktivitetin e kryer të Shoqërisë.
  13. Të mirë administrojë Shoqërinë.
  14. Të lidhë marrëveshje me të tretë në kufijtë e objektit të aktivitetit të Shoqërisë dhe të kompetencave të përcaktuara nga ortakët.
  15. Të zbatojë rregulloren e brendshme të Shoqërisë.

16. Të jetë përgjegjës për dëmet e shkaktuara Shoqërisë nga veprimet e tij.
  17. Të informohet dhe të bëjë propozime për çfarëdolloj gjëje që e vlerëson si të rëndësishme për shoqërinë.
  18. Të kryejë veprimet bankare në lidhje me llogarinë e shoqërisë.
  21. Administratorët kanë të drejtë dëtyrë të thërrasin asamblenë e përgjithshme, sipas dispozitave të përcaktuara në këtë statut dhe të ligjit aty ku nuk parashikohet shprehimi i statutit.
- 13.2. Administratorët janë përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe të tretëve për shkeljet e ligjit apo të normave të statutit që mund të ndodhin gjatë ecurisë së aktivitetit, sipas legjisacionit shqiptar.

#### **Neni 14** **Të Drejtat e Shoqërisë**

Shoqëria ka të drejtë:

1. të kryejë veprimitari në bazë të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë;
2. të siguroje pasurinë e vet;
3. të marre kredi në lekë dhe në valutë nga Bankat vendase ose të huaja në bazë të rregullave ligjore;
4. të përfitoje nga favoret që i njeh legjisacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera;
5. të investoje kudo në Shqipëri, me të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj;
6. të punësoje punëtore, vendas ose të huaj;
7. të eksportojë lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj.

#### **Neni 15** **Detyrat e Shoqërisë**

Shoqëria ka për detyrë:

1. të sigurojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohën e duhur;
2. të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria;
3. të sigurojë punonjësit e saj;
4. të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo;
5. të pajiset me leje/autorizime të mundshme, nëse kërkojnë nga ligji, për të zbatuar objektin e veprimtarisë se saj;
6. të respektojë standardet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

#### **Neni 16** **Marrëdhëni e ekonomike financiare të Shoqërisë**

E gjithë veprimtaria e shoqërisë për plotësimin e objektit të veprimtarisë së saj, pasqyrohet në bilancin ekonomik të saj.

### **Neni 17**

Në selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni finansiar, në bazë të cilit, brenda datës 31 mars të çdo viti nxirret bilanci vjetor i Shoqërisë.

### **Neni 18**

Viti finansiar fillon çdo vit më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

### **Neni 19**

Shoqëria mban llogarinë e saj në Bankë. Llogaritë mbahen në Lekë dhe valuta të tjera dhe pasqyrohen në librat kontabël përkatës.

### **Neni 20**

Nga fitimet e realizuara gjatë vitit finansiar, Shoqëria pasi bën zbritjen e humbjeve të vitit të mëparshëm, lë mënjanë 5% të fitimit, me të cilin kriohet fondi "Rezervë e domosdoshme", derisa ky fond të arrijë masën 10% të kapitalit themeltar.

### **Neni 21**

#### **Dispozita të vecanta**

Shoqëria ka vulën e saj me përmasa te zakonshme, të realizuar sipas parashikimeve të ligjit në fuqi dhe mund të ketë një markë të vetën. Në rast të krijimit të një faqe interneti, mund të deklarohet në mënyrë vullnetare në QKB.

### **Neni 22**

#### **Shndërrimi**

Shndërrimi i Shoqërisë në shoqëri të llojeve të tjera, mund të behët me vendim të ortakeve themelues sipas mënyrave të parashikuara në ligj.

### **Neni 23**

#### **Prishja e Shoqërisë**

23.1. Shpërbërja e shoqërisë, mund të vijë për shkaqet e parashikuara ne nenin 99 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 (të ndryshuar) dhe për arsyet si me poshtë:

- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuara;
- me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- me vendim të gjykatës;
- humbja e kapitalit te shoqërisë;

23.2. Ne këto raste, ortaket e shoqërisë vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose me shumë likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë se Shoqërisë deri sa ajo t'u dorëzohet personave përkatës fizike e juridike, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet qe ka shoqëria ndaj personave të tretë. Në rast se fondej e disponueshme, rezultojnë të pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve te

Shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkoje ortakeve themelues të Shoqërisë që të derdhin tërësisht kuotat që u takojnë.

**Neni 24**  
**Ligji i aplikueshëm dhe juridiksioni**

- 24.1. Për çdo gjë që nuk është parashikuar shprehimisht në Statut, i bëhet referencë dispozitave të legjislacionit në fuqi.
- 24.2. Të gjitha konfliktet që mund të lindin midis ortakëve të Shoqërisë, midis ortakëve dhe Shoqërisë, midis Shoqërisë dhe administratorit do ti nënshtronen për zgjidhje gjykatës kompetente të Republikës se Shqipërisë në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi.

**Neni 25**

Ky statut përpilohet ne 2 (dy) ekzemplare në gjuhën shqipe të nënshkruara rregullisht nga Ortaku i vetem i shoqerise.

Nënshkruar në Tiranë më datë 13/12/17

Arian Lekaj  
[emër, mbiemër, firmë]